



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:001453

Datë: 13.09.2022

Numri i dokumentit: 03415897

CP.nr.439/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Durim BALAJ, duke vendosur në lëndën e përmbartimore të kreditorëve: 1.L.M., 2.L.S., 3.L.B., 4.L.N., 5.M.B., 6.M.M., 7. N.H. 8.N.D. dhe H.B. që të gjithë nga Gjakova të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Ilir Rogova, avokat në Gjakovë, kundër debitorit Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit në Gjakovë, për shkak të pagesës së borxhit, jashtë seancës, me 13 shtator 2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përmbartimore, e udhëhequr sipas shenjës CP.nr.439/2021, e iniciuar nga kreditorët e përmbartimit L.M., LS., L.B., L.N., M.B., M.M., N.H., N.D. dhe H.B. që të gjithë nga Gjakova, kundër debitorës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit në Gjakovë, për shkak të pagesës së tërësishme të borxhit nga debitorit.

A r s y e t i m

Kreditorët e përmbartimit L.M., L.S., L.B., L.N., M.B., M.M., N.H., N.D. dhe H.B., që të gjithë nga Gjakova, kanë paraqitur propozimin për përmbartim në bazë të dokumentit ekzekutiv Aktgjykimit C.nr.19/2020, datë 22.03.2021, i marrë nga Gjykata Themelore në Gjakovë, i ekzekutueshëm nga data 30.06.2021, kundër debitorës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit në Gjakovë dhe i kanë propozuar kësaj Gjykate që të lejoj përmbartimin për shkak të borxhit të debitorit ndaj këtu kreditorëve.

Gjykata Themelore në Gjakovë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorëve të përmbartimit, me aktvendimin CP.nr.439/2021, datë 07.09.2021, ka lejuar përmbartimin ndaj debitorës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit në Gjakovë.

Pasi aktvendimi për ekzekutim CP.nr.439/2021, i datës 07.09.2022, është bërë i ekzekutueshëm Gjykata ka nxjerrë urdhër për ekzekutim, me të cilin e ka urdhëruar Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve – Thesarin e Kosovës, që nga llogaria e debitorës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të bëjë bartjen e mjeteve sikurse në urdhrin për ekzekutim CP.nr.439/2021, datë 14.04.2022, në llogari të te autorizuarit të kreditorëve, avokatit Ilir Rogova.

I autorizuari i kreditorëve, me parashtresën e datës 29.08.2022, ka njoftuar Gjykatën se Thesari i Kosovës, ka vepruar sipas urdhrin të Gjykatës duke i ekzekutuar mjetet për destinim për kreditorët, duke theksuar se procedura ka përfunduar në tërësi.

Meqenëse kreditorët përmes të autorizuarit të tyre kanë njoftuar Gjykatën, se Thesari i Kosovës ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorëve të përmbarimit, Gjykata duke u bazuar në nenin 66 paragrafi 4 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, në të cilin parashihet se “*Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore*”, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

CP.nr.439/2021, me 13 shtator 2022

GJ Y Q T A R I

Durim BALAJ

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të parashtrohet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.